URDHËR
Nr. 525, datë 10.10.2025

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK, SHKOLLA 9-VJEÇARE POLENË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të kreut I/B, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë.
2. Institucioni arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë, ka për detyrë:
a) të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Korçë-Pustec, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;
b) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Korçë–Pustec, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.
3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë–Pustec, ka për detyrë:
a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë;
b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar publik;
c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë.
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Korçë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Korçë–Pustec, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.
5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Korçë–Pustec, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Korçë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Korçë-Pustec dhe institucioni arsimor parauniversitar publik, Shkolla 9-vjeçare Polenë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani